

Shollimi profesional për të moshuar

Mundësitë dhe rrugët e aftësimin profesional

2

Intervista mbi kurset gjuhësore

Kurset të gjuhës dhe tjera mbështetëse

3

Migrantët shqiptarë të Kosovës e Shqipërisë

Mes dilemës së largimit dhe të kthimit

4

Nr. 7 | dhjetor 2015 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Ligji për të drejtën e shtetësisë

Marrja e shtetësisë mbetet arbitrare



Procedurat për marrjen e pasaportës zvicerane sa vijnë e bëhen më të rrepta

Në vitin 2014 Parlamenti aprovoi ligjin për të drejtën e shtetësisë. Një vit më pas pason rregullorja që përcakton zbatimin e ligjit në fjalë. Për sindikatën Unia është e qartë: Qeveri federale me rregulloren e propozuar për revidimin e tërësishëm të ligjit në fjalë ka humbur shansin të garantojë procedura koherente, transparente dhe korrekte për marrjen e shtetësisë. Kriteret janë formuluar paqartësisht dhe edhe më tej janë lënë derë e dritare hapur për diskriminim dhe arbitrazh. Njerëzit në situata të përkeqësuar në tektin e propozuar të rregullores janë të përjashtuar dhe të diskriminuar.

Revidimi i fundit i ligjit ka ndodh ne vitin 1952. Është koha që ligji të modernizohet. Kjo domethënë që kriteret të harmonizohen dhe të njësohen, të jenë të qarta dhe korrekte, që të eliminohet diskriminimi dhe keqtrajtimi. Kjo shanse mjerisht është humbur. Pas diskutimeve të shumta, Parlamenti me rastin e revidimit të përgjithshëm në vitin 2014 është zotuar të fuqizoi një ligj

shtetësie korrekt, transparent dhe të harmonizuar. Migrantëve/eve ju duhet edhe më tej të presin për një procedurë korrekte, të liruar nga diskriminimi dhe keqtrajtimi. Kriteret të njësuara dhe me shanse të njëjta me rastin e procedurës së marrjes së shtetësisë mbetet vetëm një dëshirë e përealizuar.

Cilat janë risitë?

Ndryshimet e rëndësishme janë me sa vijon: Afati minimal i qëndrimit në Zvicër nga 12 vite shkurtohet në 10 vite. Rishtas vitet qëndrimit nga mosha 8 deri në atë 18 vjeç do të llogariten dyfish dhe jo sikur deri më tani nga mosha 10 deri 20 vjeç. Koha e qëndrimit të personave me leje qëndrimi të përkohshëm, pra me lejen F, duhet të llogaritet si gjysma e kohëzgjatjes së qëndrimit. Risia tjetër është se vetëm të huajt që posedojnë lejen e përhershme të qëndrimit C mund të aplikojnë për marrje të shtetësisë. Edhe sa u përket kriterëve të integritetit kemi risi të posaçme. Këtu duhet pasur parasysh respektimin e sigurisë dhe rregullit publik, respektimi i vlerave të kushtetutës federale, pjesëmarrja në jetën ekonomike (punësim) apo shkollim si dhe cytja dhe mbështetja e integritetit të anëtarëve tjerë të familjes. Risi është

gjithashtu se tanimë nuk mjafton vetëm të posedohen njohuri verbale (gojore) të gjuhës vendore, porse ajo duhet të zotërohet edhe e shkrim.

Paqartësi mbi «kriteret integruese»

Propozimi i qeverisë federale me rregulloren e ligjit për të drejtën e shtetësisë do të duhej të paraqiste konkretizim të të ashtuquajturave kriteret integruese. Por, kriteret mbesin shumë të paqarta dhe vështirë të dalluara. Kështu nuk është e dukshme se cili është dallimi mes «integritetit» dhe «rrethanave të njohura jetësore zvicerane». Shumë konkretizime përkeqësojnë rrezikun e arbitrazhit dhe ndihmojnë fare pak në vlerësim.

Njerëzit në kushte të pasigurta të jetesës në pozitë të pafavorshme

Veçanërisht e rënduar është risia, e cila parasheh, që marrësit e ndihmës sociale të mos lejohen të aplikojnë për marrje shtetësie. Një shembull i qartë se si rregullorja e planifikuar e ligjit të ri mbi të drejtën e shtetësisë përjashton dhe disfavorizon njerëzit e lëndueshëm punëtorë e të varfrit. Marrja e shtetësisë mbetet përfundimisht një privilegj i rezervuar vetëm

për njerëzit me arsimim të lartë dhe me siguri të lartë financiare. Ky është një diskriminim, të cilin Unia e refuzon qartë.

Marrja e shtetësisë paraqet hap të rëndësishëm për integrim

Unia edhe më tej është e mendimit se marrja e shtetësisë nuk paraqet «kurorën» e integritetit, porse si e tillë paraqet një hap të rëndësishëm në drejtim të integritetit. Andaj proceduara e marrjes së shtetësisë do të duhej të ishte më e thjeshtë, e qartë, korrekte dhe koherente. Zvicra ka interes që njerëzit pa pasaportë zvicerane sa më shpejtë ti pranojë si pjesë të shoqërisë së saj. Pasi nuk është në rregull që çereku i popullatës të mos ketë të drejtë të marr pjesë në jetën politike. Do të ishte pos tjerash edhe pranim e njohje e kontributit të migrantëve e migrantëve për shoqërinë zvicerane, gjë e cila qysh moti do të duhej të ndodhte.

Jo vetëm Unia ka qëndrim kritik karshi këtij ligjit dhe zbatimit të tij. Edhe Komisioni Federal për Migracion (EKM-CFM) ka vlerësuar me notë të pamjaftueshme ligjin dhe rregulloren në fjalë.

Editorial



Të dashura lexuese, të dashur lexues

Në fillim të këtij viti ne gjendeshim në vrullin e përgatitjeve për Kongresin e migrantëve e migrantëve dhe njerëzve m sfond migracioni. «Kongresi» ishte një hap i parë, që organizatat nga fusha migracionit të ndërlihen më fuqishëm mes veti. Ne dëshironim të bënim hapin e parë edhe në drejtim të ndryshimit të mendësisë: Migrantet e migrantët janë pjesë e Zvicrës, ata jetojnë këtu dhe qëndrojnë këtu! Ne, të cilët jemi këtu kemi po ato të drejta sikur edhe ata që do të vijnë më pas. Ne të gjithë jemi Zvicra. Kjo mendësi, një paraqitje më e vetëdijësuar ishte dhe është e nevojshme, posaçërisht nëse ne paraprakisht i hedhim një sy vitit 2016 që është para nesh.

Aprovimi i iniciativës së SVP-së «Stop migrimit masiv» ka qar në rritje të pasigurisë. Edhe gati dy vite pas kësaj, ne nuk dimë ende, se si do të zbatohet ajo. Frikësues është fakti se janë duk u rritur e fuqizuar zërat për të reduktuar të drejtat e migrantëve. Dhe jo vetëm këtë: të drejtat e punëmarrësve, të drejtat sociale, bile edhe të drejtat njerëzore duan ti reduktojnë.

Edhe zgjedhjet parlamentare në tetor si dhe zgjedhjet në qeverinë federale tregojnë: po vijnë kohë të vështira. Kampi konservator është bërë edhe më i fortë pas këtyre zgjedhjeve. Pikërisht SVP-ja dëshiron të shkatërroj që të gjitha të drejtat themelore, qoftë të zviceranëve qoftë të migrantëve.

Në vitin 2016 Unia në rrafshin e brendshëm do të karakterizohet kongresin e saj të rregullt! Në fund të tetorit në Gjenevë do të zgjidhet udhëheqja e re dhe do të vendosen orientimet themelore për punën tonë në katër vitet e ardhshme. Edhe në vitin 2016 neve na presin shumë beteja!

Gëzuar festat dhe urojmë një vit të ri të mbarë!

Rita Schiavi

Anëtare e udhëheqjes qendrore të Unia-s

News

Ditët e aksionit në 2 vjetorin e aprovimit të BV 121a

Grupet regjionale të Migracionit të Unia-s bashkë me Organizatat tjera nga 6-9 shkurt 2016 në vendbanime të ndryshme zvicerane do të jetë prezentë me manifestime dhe aktivitete, për të reaguar me rastin e 2 vjetorin të kalimit të Iniciativës së SVP-së «Stop migrimit masiv», dhe për të përkujtuar se migrantet/ët janë pjesë e Zvicrës, të cilët kërkojnë të drejtat e tyre. Ditët e aksionit do të zhvillohen me moton «Ne të gjithë jemi Zvicra»!

KKP për shitoret e pikave të karburanteve



Shoqata e pronarëve shitoreve të pikave të karburanteve të Zvicrës (VTSS) dhe sindikatat Unia e Syna si dhe Shoqata e Kontabilistëve të Zvicrës kanë negociuar një Kontratë të Kolektive të Punës (KKP) për shitoret e pikave të karburanteve. Kontrata mbron kushtet e punës të të punësuarve në tërë Zvicrën. Kontrata e Kolektive të Punës duhet të hyjë në fuqi më 1 janar 2017 dhe të shpallet me vlefshmëri të përgjithshme.

Të dhënat e përgjithshme: Pagat minimale: Në shumicën e kantoneve 3700 franga (për të pakualifikuarit) /4000 franga (me shkollim profesional 2 vjeçar)/4100 franga (me shkollim profesional 3 vjeçar) në muaj (x13), ndërsa në kantonet kufitare më pak të prekura nga fuqizimi i frangut zviceran 3600/3900/4000 franga. Orari i punës: 42 orë pune në javë; pagesë shtesë prej 5% për ditët e punës të dielave dhe festave.

Rritje pagash për mjeshtëritë në Zvicrën frankofolëse

Rreth 17000 punëmarrësve në ndërtimtarinë artizanale në Zvicrën frankofolëse do të marrin paga më të larta në vitin 2016. Partnerët social kanë arritur një marrëveshje për tërë këtë sektor ekonomik. Punëtorët e punëtorët përgjithësisht do të marrin një pagë më të lartë prej 1% si dhe varësisht nga kontributi edhe rritje individuale pagash prej 0,3%.

Inspektorët sindikalist të punës në Gjenevë

Parlamenti i Kantonit të Gjenevës dëshiron të luftojë më fuqishëm dumpingun në vendin e punës. Nga viti i ardhshëm krahas kontrolluesve kantonale do të ketë edhe nga 12 inspektor/e të sindikatave dhe po nga 12 të punëdhënësve, të cilët duhet të kontrollojnë respektimin e kushteve të punës dhe të pagave. Kjo është një arritje shembullore për Zvicrën.

Shkollimi dhe trajnimi i mëtejme

Shegertët e moshuar



Kursi «ProgreDir», një ndër mundësitë dhe rrugët për nxënjen e arsimit profesional të mëvonshëm për migrantët

Kur erdhën nga Portugalia në Zvicër Dora dhe Francisco Machado, nuk kishin të kryer shkollimin profesional. Sot ata të dy janë të diplomuar.

Në Zvicër rreth 620000 të rritur në moshën e punësimit nuk kanë të kryer shkollimin profesional. Sipas sekretariatit shtetëror për arsim, humlumtim e inovacion (SBF) këta janë shpesh të papunë apo të punësuar e paga tejet të ulëta.

Francisco Machado përpara ishte njëri nga ta. Para se ai të vinte në Zvicër para 17 vjetëve, pati punuar katër vite si zdrukthëtar. Atij i mungonte vetëm shkollimi formal profesional. «Shkollim profesional në Portugali kishte vetëm nëpër qytete. Unë banoja shumë larg qytetit, andaj fillova menjëherë me punën.» Megjithatë, Machado si 37 vjeçar gjeti shpejt një vend punë në një zdrukthëtar në Waadtland. Ai u anëtarësua në sindikatën Unia dhe një sekretar sindikal e informon dhe ia bënë të qartë se ai edhe si i rritur mund të merre certifikatën shtetërore profesionale (EFZ). Për Machado ishte e qartë: «Do ta bëjë shkollimin. Unë isha i etur për arsimim të mëtejme». Me diplomë atij iu rrit paga dhe shanset për vende tjera të ardhshme pune. Gjithashtu ai krijoi edhe mundësin për studime të mëtejme.

Rrugë të ndryshe për EFZ

Mundësitë për përfundimin e një shkollimi të tillë profesional janë të shumta: Kushdo si i rritur që nuk ka shkollim profesional, ka mundësi të bëjë tërë shkollimin profesional, apo të ndjekë dhe përfundojë një arsimim

të shkurtuar profesional. Në të dyja rastet nevojitet një vend praktike pune, një arsimtar profesional dhe një kontratë për aftësimin profesional (shegert).

Aftësimi i shkurtuar profesional

Francisco Machado vendosi për variantin e «aftësimit të shkurtuar profesional». Pasi ai kishte mjaft përvojë profesionale, sipas nenit 32 të ligjit për aftësim profesional ai ka mundësi individuale të formësimit profesional. «Dhe unë isha i ngazëllyer për të mësuar» thotë ai. Për tri vite rresht Machado, çdo te shtunë ndiqte arsimimin praktik në shkollën e ndërtimtarisë. Ndërsa çdo të premtje pasdite vizitonte kurset për arsimim të përgjithshëm he teori profesionale në shkollën profesionale.

Njëherazi ai punonte me orar të plotë në ndërtimtarinë. Kjo është e mundur, pasi java e tij e punës përfundon të premtjen pasdite. Kur në vitin 2007 zdrukthëtar morri diplomën në dorë, kishte lënë pas veti një periudhë kohore veçanërisht të lodhshme: Ai ka dy fëmijë, djali i tij posa ka mbush 1 muaj, vajta është dy vjeçe. Jeta familjare, puna me orar të plotë dhe shkollimi profesional nuk është edhe aq e lehtë për ti kënaqur të tria bashkë. «Mua mu është dashur ti organizoi të gjitha vet. Rrugën e arsimimit, shkollën, provimet.» shpjegon ai.

Shtatë vite më pas Machado nuk punon më si zdrukthëtar. Diploma profesionale atij i ka hapur rrugë trajnimeve të mëtejme. Ai ka ndjekur shumë kurse në institutin e sindikatave «Movendo». Për momentin ai është duke e bërë arsimimin për ekspert të sigurimeve shoqërore dhe është duke punuar si sekretar sindikal në Unia: «Më këtë rast i bindi bashkëvendësit e mijë për kuptimin e arsimimin e vonë profesional», thotë ai.

Kursi profesional për portugeze

E para që ndezë zjarrin në këtë drejtim është bashkëshortja e tij Dora. Edhe kjo 39 vjeçare vjen gjithashtu nga Portugalia dhe menjëherë pas përfundimit të shkollimit të detyrueshëm angazhohet me punë në ndërmarrjen e prindërve të saj. Pastaj punon edhe në Kanada si kujdestare. Me burrin e saj është njohur qysh në Portugali, dhe pos një kohe të shkurtër bashkë me te vijnë në Zvicër. «Edhe pse unë dija mirë anglishten, frëngjishten e folja dobët, andaj edhe kam kërkuar vend pune, në të cilin unë jo domosdoshmërisht duhet të flas shumë», shpjegon ajo. Së pari në një hotel, ndërsa ka vite se punon si shtëpiake për ndërmarrje të ndryshme banesore.

Përparim – ProgreDir

Unia dhe fondacioni arsimor ECAP kanë nisur një kurs profesional për migrantet në Kantonin Waadt: «ProgreDir» përkthyer nga portugalishtja në shqip domethënë «Përparim» dhe

për fillim ofron një shqyrtim situatë dhe pozicionim. Më vonë gratë kanë mundësi që krahas kurseve kualifikuese në sektorin e pastrimit, tregtimit me pakicë, gastronomisë dhe në amvisni ekonomike, të ndjekin edhe mësimin gjuhësor. Perfekt për Dora Machado. Gjatë arsimimit dyvjeçar ajo përballej me të njëjtat vështirësi sikur i shoqi më herët: «Nuk ishte fare e lehtë të futësh nën një kapelë familjen, punën dhe shkollimin». Ndryshe nga i shoqi ajo nuk duhej vet ti kryente lëndët mësimore. Në ndërkohe ajo flet gati pa asnjë gabim frëngjishten. «Dëftesa e aftësisë profesionale nuk ka ndikuar në pagën time – firma paraprakisht më ka paguar sikur të kisha të mbaruar arsimimin përkatës. Mirëpo nëse më duhet të kërkoj ndonjëherë vend tjetër pune, e ndiej vetën më të sigurt».

© Sina Bühler

Miratimi i dosjeve: Shembulli bie në sektorin e ndërtimtarisë

Jo vetëm punëmarrësit përfitojnë nga përparësitë me rastin e kualifikimeve profesionale. «Edhe punëdhënësit janë të interesuar të kenë personel profesional», sqaron Riccardo Mero, udhëheqës i kursit themelor tek Shoqata e Punëdhënësve. Për këtë arsye Shoqata e Punëdhënësve bashkë me drejtorinë e edukimit të kantonit të Bernës kanë përpunuar procedurën e vlefshmërisë. Me rastin e vlefshmërisë – njëri nga 4 rrugët e arritjes së dëftësës së aftësisë profesionale, të përmendura në tekstin kryesor – ekspertët me përvojë profesionale dorëzojnë një dosje, e cila dëshmon aftësinë në praktikë. Kjo vlerësohet nga dy ekspertë, të cilët më pas ftojnë për një bisedë profesionale. Nëse dosja pranohet, atëherë lëshohet edhe certifikata shtetërore e aftësisë profesionale (EFZ) për profesionet përkatëse. Risi në ofertën e Bernës është se kjo mundësi është e hapur për të interesuarat/it nga e gjithë Zvicra.

Manifestime informuese organizohen tek BIZ Bern-Mittelland, Bremgartenstrasse 37, 3012 Bern. Datat dhe hollësitë mund ti gjeni në: www.erz.be.ch/validierung



Migrantet portugeze vijuese të kursit «ProgreDir» (Përparim) në Zvicrën frankofolëse

Politika industriale, Frangu i fuqizuar

Delegatët e Unia-s deklarohen kundër de-industrializimit



Pamje nga mbledhja e delegatëve të sektorit të industrisë në Unia

Delegatët e Unia-s të sektorit të industrisë përmes një rezolute kanë propozuar një front të gjerë kundër de-industrializimit. Ata kërkojnë nga punëdhënësit që bashkërisht të rrisin presionin karshi Bankës Kombëtare të Zvicrës (SNB). Me këtë rast sindikatat janë të mbështetura nga Dr. Bruno Müller-Schnyder, ish këshilltari i SNB-së.



Dr. Bruno Müller-Schnyder



Corado Pardini

Zhvillimet e reja në industri tregojnë: Tronditja e shkakuar nga frangu është duke shpalosur ndikimet shkatërruese. Eksportet kanë rënë në të nivelet e gjera. Vetëm në tremujorin e tretë të vitit 2015 janë zhdukur për 9,1% eksportet e industrisë MEM, ndërsa të asaj të industrisë së orëve për 8,6% (në vlerë). Numri i të papunëve në krahasim me vitin e kaluar në industrinë e metalit është rritur për 22,6%, në atë të makinerisë për 29,9%, ndërsa në industrinë e orëve për 33,4%. Për shkak të tronditjes nga frangu është duke ndodh de-industrializimi. Ndërmarrjet e mëdha industriale janë duke kaluar tek furnizuesit e huaj. Kjo shkatërron strukturat e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Dhe gjithnjë më shumë firma janë duke i kaluar vendet e punës drejtpërdrejt jashtë Zvicrës.

Krizë e vetë shkakuar

Nga këndvështrimi i sindikatës Unia, kriza është shkakuar nga vet përgjegjësit. Përgjegjës në radhë të parë është Drejtoria e Bankës Kombëtare

(SNB). Me heqjen e kursit minimal të këmbimit më 15 janar 2015 ka ndërmarrë një vendim fatal. Mirëpo edhe parlamenti i dominuar nga partitë e djathta SVP e FDP bashkë me qeverinë federale kanë refuzuar deri më tani t'ia përkujtojnë përgjegjësit dhe detyrimet SNB-së, të zhvilloi një politikë monetare në interes të vendit. Andaj, delegatët e Unia-s në mbledhjen e delegatëve në muajin nëntor kërkojnë nga punëdhënësit menjëherë bashkërisht me sindikatat sa më shpejtë të detyrojnë SNB-së të zhvlehtësojë frangun e fryrë në mënyrë vrastare. Sa më parë që është e mundur për frangun duhet të realizohet një kurs këmbimi i pranueshëm.

Ekspertët bëjnë fajtorë bankën kombëtare

Të njëjtën gjë e vërteton edhe Dr. Bruno Müller-Schnyder, konsulent dhe ish bashkëpunëtor e këshilltar i Bankës Kombëtare. Në referatin e tij, Müller-Schnyder bëri të qartë se SNB-ja mban përgjegjësi. «SNB aktualisht është e vetja bankë moneta-

re në botë pa politikë të deklaruar monetare» thotë specialisti. Vetëm kursi minimal i ri i këmbimit, sipas Müller-Schnyder mund të ndihmojë të mënjanohet de-industrializimi. Udhëheqja aktuale e SNB-së nuk gëzon besimin pas shkakut të frikës me politikën e saj zhvlerësuese.

Nevojitet një kthesë politike

Rreth 10 muaj pas vendimit fatal, për të hequr kursin minimal të këmbimit, pasojat janë të dukshme. Tani Banka Kombëtare duhet të veproj, për të mënjano de-industrializimin e Zvicrës. Sindikata Unia tregohet e gatshme për zgjidhje nëpër ndërmarrjet, siç tregon fjala bie rasti «Stadler Rail». Parakusht janë transparenca e numrave (llogarive) dhe garantimi i vendeve të punës. Mirëpo për krizën e shkakuar nga frangu nuk zgjidhje ndërmarrëse, por vetëm zgjidhje politike. Ne nuk do të biem në kurth, të pranojmë që ndërmarrje pas ndërmarrjeve demontimin e të arriturave tona.

© Aurora Garcia



Banka Kombëtare e Zvicrës kërkohet të ndërmerr masa në interes të vendit

Përse është i rëndësishëm frangu i qëndrueshëm e jo ai i mbivlerësuar?

Një monedhë e qëndrueshme është një pasuri publike dhe për ekonominë dhe shoqërinë aq e rëndësishme fjala bie sa edhe siguria juridike. Ndërmarrjet anë nevojë për monedhë të qëndrueshme, në bazë të së cilës mund të bëjnë kalkulimet e tyre. Mirëpo, aktualisht në tregjet e devizave, frangu i është nënshtruar një spekulimi masiv, andaj edhe është i paqëndrueshëm. Një kurs këmbimi shpeshtë dhe i ndryshuar pandërrerë pengon planifikimin e arsyeshëm në ndërmarrësi. Mbivlerësimi i frangut disfavorizon sektorin e turizmit dhe industrinë zvicerane të eksportit në tregun botëror.

Intervistë



Përfundim i suksesshëm i kursit të gjermanishtes të organizuar nga Unia për punëtorët portuges të bujqësisë në Ins

Njohurit gjuhësore mundësojnë avancimin profesional

Unia u ofron anëtarëve të saj një mori të kurseve gjuhësore si dhe të kurseve tjera mbështetëse, që ofrohen nga komisioni i paritetit.

Ku mund të drejtohem, kur dua të ndjek një kurs gjuhe?

Drejtohu tek seksioni Yt i Unia-s, cilat kurse mbahen në afërsi të vendbanimit apo vend-punimit Tënd. Unia shumicën e kurseve i ofron në bashkëpunim me institutin arsimor ECAP/Formziona. Ti mund të interesohesh edhe drejtpërdrejt tek ECAP/Formazione (adresën e gjen në fund të shkrimit)

A do të mbështetem financiarisht nëse unë ndjek një kurs gjuhe?

Po. Mësimi i njërës nga gjuhët vendore mbështetet financiarisht nga Unia. Ka edhe shumë kurse, të cilat janë falas për anëtarët tanë. Kështu për shembull kurset për punëmarrësit/it ë punojnë në sektorin e pastrimit, gastronomisë dhe ndërtimtarisë kryesore, ofrohen nga komisioni i paritetit dhe janë pa pagesë.

A duhet të pajtohet punëdhënësi im, që unë të mund të vizitojë kursin gjuhësor?

Shumica e kurseve duhet të ndiqen në kohën e lirë, fjala bie të shtunave. Andaj për këtë nuk është e nevojshme të pyetet për leje punëdhënësi. Shumë punëdhënës janë të kënaqur dhe mbështesin të punësuarit e tyre, të cilët duan të mësojnë gjuhën. Në sektorin e ndërtimtarisë dhe atë të pastrimit ne i ofrojmë kurset në bashkëpunim me punëdhënësit. Shumë punëdhënës i informojnë të punësuarit e tyre edhe mbi mundësit e ndjekjes së kurseve të gjuhës.

Nëpër kantiere në shumicën e rasteve nuk flitet fare në gjermanisht dhe frëngjisht. Kryepunëtore është vet i huaj dhe flet gjuhën e punëtorëve. Edhe në sektorin e pastrimit operojnë shumë firma, të cilat bëjnë bashkë ekupe të punës, të cilat flasin të njëjtën gjuhë. Nuk duhet të njohim fare gjuhën e vendit për të kryer punën.

Në shumë ndërmarrje kjo është realitet dhe çështjen e bënë të vështirë për shumë migrante e migrantë mësimin e gjuhës së vendit. Mirëpo kus-hdo që mëson të flet mirë gjermanishten apo frëngjishten, ka më shumë mundësi profesionale. Kush njih gjuhën vendore mund të angazhohet më lehtë për punë të ndryshme, të cilat mund ti kryejë edhe në mënyrë të pavarur. Andaj ne mbështesim dhe cytim mësimin e gjuhës vendore.

A mund të fitoi më shumë, nëse unë flas mirë gjuhën vendore?

Njohurit e mira të gjuhësore janë me rëndësi, për të përparuar në aspektin profesional. Nëse Ti dëshiron të vijosh trajnime e aftësime të mëtejme, atëherë ti duhet ta kuptosh gjuhën vendore si de ta lexosh atë. Nëse pra Ti dëshiron të kualifikohesh më tej, duhet të njohësh mirë gjuhën vendore. Punonjësit e kualifikuar fitojnë më mirë se sa at që janë të pakualifikuar. Në sektorin e pastrimit ne jemi duke e përgatitur ripërtëritjen e Kontratës Kolektive të Punës. Nga viti 2018 do të duhet të kishim një shkallëzim të ri të kualifikimeve. Sa më të kualifikuar që janë njerëzit, a më shumë duhet të fitojnë ata. Kurset e trajnimit e mëtejme profesionale mund ti vijojnë vetëm ata që njohin gjuhën vendore.

Unë kam qenë vetëm pak vite në shkollë. Unë mendoj se shkolla për mua është e komplikuar. Kam frikë se nuk do të kuptoj asgjë në kursin e gjuhës gjermane?

Kurset të cilat ne i ofrojmë dhe preferojmë, janë të ndërtuar në mënyrë speciale për punonjësit me pak përvojë shkollore. Ato janë të ndërtuara në atë mënyrë, që vijuesit shumë shpejt të mësojnë ato që u nevojiten në punë dhe përditshmëri. Pra, nuk ka nevojë të trembet askush.

© Rita Schiavi

ECAP Vendet e kurseve: www.ecap-kurse.ch

- Ecap Aargau: infoag@ecap.ch
- Ecap Basel: infofs@ecap.ch
- Ecap Solothurn: infoso@ecap.ch
- Ecap Zentralschweiz: infolu@ecap.ch
- Ecap Ticino Unia: infoti@ecap.ch
- Ecap Vaud: infovd@ecap.ch
- Ecap Winterthur: infowt@ecap.ch
- Ecap Zürich: infozh@ecap.ch
- Formazione Bern: infofe@ecap.ch

Migrantët e punës nga Shqipëria dhe Kosova

Shqiptarët mes dilemës të largimit dhe të kthimit



Pamje nga konferenca ndërkombëtare në Tiranë mbi migrantët e punës dhe qytetarinë industriale

Nga 14 deri 15 nëntor 2015 në Universitetin «New York» të Tiranës u zhvillua Konferenca ndërkombëtare me temën kryesore «Migrimi i forcës së punës dhe qytetaria industriale: Shqiptarët në lëvizje, identitet, zhvillim dhe qytetari». Konferenca bashkë me referatet e ekspertëve dhe specialistëve të fushave të ndryshme hasi në interes të madh të rretheve institucionale dhe profesionale që merren me tematikën në fjalë.

Shqiptarët në udhëkryq: midis largimit, rikthimit e në kërkim të identitetit e qytetarisë

Në Shqipëri e Kosovë rrallë ndodh të gjuhë familje që nuk është prekur nga emigrimi në një formë apo në një tjetër. Prej 25 vitesh shqiptarët e përdorin emigrimin si përgjigje ndaj izolimit, kushteve të vështira ekonomike e sociale e shpesh edhe për ti shpëtuar situatave konfliktuale me sfond politik apo social. Emigrimi, megjithëse fillimisht ilegal dhe shpesh i rrezikshëm (nëpërmjet detit apo dhe përmes maleve) ka qenë një zgjidhje efektive kundër varfërisë, një strategji mbijetese duke ndikuar në arritjen një niveli më të lartë jetese. Gjatë gjithë këtyre viteve, dërgesat financiare të emigrantëve kanë qenë në lidhura drejtpërdrejt me mbijetesën e familjarëve të emigrantëve në Shqipëri por njëkohësisht kanë pasur një ndikim të konsiderueshëm dhe në ekonominë kombëtare. Për më tepër, rritja e nivelit të jetesës, nga dërgesat e emigrantëve, ka nxitur migrimin e brendshëm të popullsisë (familjarëve të emigrantëve) duke shkaktuar një polarizimin hapësinor të vendit, me mbipopullim të rajonit qendror e me braktisje të zonave të thella rurale kryesisht ato veriore.

Migrimi si fenomen global

Megjithëse migrimi ka qenë një përgjigje efektive kundër varfërisë ka pasur dhe pasoja negative të mëdha si për vendet e origjinës ashtu dhe për vetë migrantët dhe familjet e tyre. Kështu ndër problematikën më të mëdha që kanë shoqëruar emigrimin e Shqiptarëve mund të përmendim numrin e madh të të larguarve duke arritur nivele të pakrahshueshme në shkallë globale. Largimi i popullsisë ka çuar në prishjen e dinamikave dhe të strukturave demografike në vend, si shtrembërim të piramidës së moshës dhe të gjinisë apo dhe pasoja për tregun e punës. Vendi ka krijuar një varësi jo të shëndetshme nga dërgesat ekonomike të emigrantëve si dhe është prekur nga largim të konsiderueshëm i intelektualëve dhe i fuqisë punëtore. Megjithëse pas më se 25 vjetësh Shqiptarët po integrohen relativisht suksesshëm në vendet pritëse duke krijuar dhe forcuar komunitetin e ata ende vazhdojnë të kënë probleme në plane të ndryshme siç janë punësimi në informalitet, lejet e qëndrimit, bashkimi familjar, stereotipizimi në media, stigmatizimi në opinionin publik, marginalizimi

në tregun e punës etj. Probleme të cilat janë thelluar në kushtet e krizës ekonomike globale që ka prekur vendet ku ata jetojnë (kryesisht Greqinë dhe Italinë), duke i bërë emigrantët shqiptarë një ndër grupet më të prekur nga efektet e krizës në vendet pritëse.

Kriza dhe dilemat e rikthimit

Kriza ekonomike globale, veç të tje-rash ka çuar dhe në dinamika të reja në mobilitetin e Shqiptarëve. Nën ndikimet e krizës, një numër gjithnjë e në rritje i shqiptarëve kanë marrë vendimin të kthehen në Shqipëri. Sipas INSTAT-it rreth 135000 shqiptarë janë rikthyer në Shqipëri vetëm midis viteve 2009–2013. Në këto kushte është nevojë imediate për Shqipërinë që të akomodojmë këto valë rikthyes dhe ta bëjmë ri-integrimin e njerëzve më të lehtë në atdheun e tyre. Njëkohësisht me rritjen e numrit të rikthimeve ka një dhe një rritje e emigracionit nga Shqipëria në formë azil kërkuesish. Mbi 100000 janë sot azilantët shqiptarë vetëm në Gjermani, të dytët në numra pas sirianëve. Siç shohim po evoluojnë forma të reja të lëvizshmërisë dhe migrimin nuk mund ta shohim më si një vendim përfundimtar dhe të pakthyeshëm por përkundrazi si dinamik dhe të ndryshueshëm.

Në kushtet kur çështja e emigracionit është kthyer në një nga sfidat më të mëdha për botën e sotme si dhe në dritën e sfidave që po përballet emigracioni Shqiptar sic janë: integrimi i emigrantëve në tregun e punës së vendeve pritëse, bashkëjetesa dhe menaxhimi i krizës ekonomike, format e reja dhe të mbivendosura të mobilitetit, çështje të identitetit dhe qytetarisë etj. Vjen edhe konferenca ndërkombëtare e datave 13–14 Nëntor 2015, në Universitetin e New York në Tiranë me temën kryesore «Migrimi i forcës së punës dhe qytetaria industriale: Shqiptarët në lëvizje, identitet, zhvillim dhe qytetari» me përfaqësues të shquar të akademisë, politikës, shoqërisë civile, por dhe me prezencën dhe zërin e emigrantëve.

Mungese e kërkimeve shkencore

E vërteta është se ka shumë pak kërkime lidhur me statusin, qëndrimet dhe strategjitë që migrantët shqiptarë ndjekin për të depërtuar suksesshëm në tregun e punës në vende të ndryshme evropiane. Gjatë viteve të fundit, lëvizja e shqiptarëve prej dhe

drejt vendeve të BE-së është intensifikuar ndërsa janë shfaqur trende të reja të kësaj lëvizshmërie. Nocionet e identitetit, përkatësisë, integritimit dhe formave të tjera të shtetësisë po sfidohen dita-ditës nga format e reja të lëvizshmërisë. Por si ndikojnë këto forma të reja tek zhvillimi i qytetarisë industriale midis migrantëve nga Shqipëria? Qëllimi i kësaj konference ishte pikërisht nxitja e debatit mbi këto çështje të rëndësishme. Gjithashtu kjo konferencë propozoi stimulimin e studimeve që angazhohen me transformimet aktuale të Ballkanit Perëndimor, tregun Evropian të punës, kuptimin dinamik të «emigrantit» dhe integrimin e tyre në tregun e punës dhe në shoqërinë pritëse të ndikuara këto edhe nga kriza globale ekonomike dhe politikat shtetërore. Konferenca tërhoqi një numër të lartë të pjesëmarrësve dhe prezantoi projekte hulumtuese shkencore shumë interesante si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Nga një numër i madh i punimeve shkencore paraqitura, këshilli shkencor përzgjedhi 43 prezantime që u ndoqën nga më shumë se 80 akademikë dhe 120 pjesëmarrës të ftuar që erdhën nga 14 vende të ndryshme në mbarë botën. Interesi i treguar për pjesëmarrje në këtë konferencë si edhe cilësia e hulumtimeve dëshmon që tema të tilla, siç është migrimi, janë të një rëndësie të lartë.

Kërkohet edhe angazhimi shtetëror

Një rol të rëndësishëm u kolaudua se duhet të luajë dhe shteti Shqiptar, rol i munguar deri më sot. Ndërhyrja e shtetit duhet kryesisht në legjimitetin e punës së emigrantit, njohjen e viteve të punës, sigurimeve shoqërore, etj. Shumë migrantë hedhin poshtë vite e vite pune dhe kontribute pa mundur të sigurojnë një pension. Sidomos në kushtet e krizës ekonomike dhe rritjes të nivelit të rikthimit të emigrantëve, ky i fundit kthehet në një problem të mprehtë. Shqipëria duhet të ketë një agjendë të detajuar mbi çështjen e emigracionit dhe ndihmesën që duhet ti japë qytetarëve të vet në emigrim. Shqiptarët mund të jenë ndër komunitetet e vetme të emigrantëve të konsoliduar që nuk ushtrojnë ende të drejtën dhe detyrën njerëzore të votës duke i bërë ata të heshtur në vendimmarrje dhe në politikë-bërje. Konferenca përforcoi edhe njëherë rëndësinë e rolit të emigrantëve në kapitalin social-ekonomik të një vendi, sfidat e emigracionit shqiptar dhe ndërkombëtar si edhe angazhimin e aktorëve kyç për një bashkëpunim më frytdhënës mes tyre për standardizimin e praktikave më të mira në përkrahje të emigrantëve.

E përpunuar:
Dr. Erka Çaro, Studiuose për çështjet e migracionit dhe koordinatore e projektit ICM



Vetëpunësimi: A kam mbështetje?

Në tri vitet e kaluara kam punuar në një dyqan buke e ëmbëlsirash në Bernë. Mjerisht shefit tim i është dashur që për shkaqe ekonomike të më largoi nga puna – dhe unë jam lajmëruar si i papunë. Në të vërtetë qysh pas përfundimit të shkollimit profesional (zanatit) kam pasur si synim të vetëpunësohem. Andaj tani desha të shfrytëzoj shansin. Pra, unë nuk dua të jem i punësuar nga të tjerët, por të hapi një ndërmarrje. A më mbështetë sigurimi i papunësisë në fazën fillestare?

Po, kjo është e mundur. Ligji për sigurimin. Sigurimi i papunësisë parasheh, se ata që duan të pavarësohen, mund të marrin mbështetje gjatë fazës së planifikimit të projektit të tyre. Konkretisht kjo domethënë: Për përgatitjen e hapjes së ndërmarrjes 90 ditë paga ditore, nëse i plotësoni kushtet si në vijim: Ju keni mbetur i papunë pa fajin tuaj. Kjo domethënë, ju nuk keni anuluar vet kontratën për vendin e juaj të punës dhe se punëdhënësi juaj nuk u ka larguar nga puna për shkak të sjelljes suaj, apo për shkak të lëndimit të obligimeve tuaja në punë. Ju jeni së paku 20 vjeç dhe mund të paraqitni një projekt në pika të vrazhda, pemës të cilit doni të bëheni i pavarur. Drejtohuni me preokupimin e juaj tek këshilltari juaj personal i qendrës regjionale për ndërmjetësim të punës (RAV). Aty do të merrni mbështetje për shtrimin e kërkesës gjegjëse.

Markus Widmer, work, 5.11.2015

Koha e punës: Çka duhet të më paguajë shefja ime?

Unë punojë në një shtore të vogël lagjeje si ndihmës-shitëse. Shitorja është hapur nga hëna deri të premten duke filluar nga ora 8 deri 12 dhe nga ora 14 deri 18. Unë jam përgjegjës kryesisht për arkën. Për të pasur mundësi që ta hapi atë saktësisht në ora 8, më duhet që së paku 10 minuta më herët të jam tek vendi i punës, për të bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme. Dhe në mbrëmje, kur e mbylлим shitoren në ora 18:00 mua me duhet që për të bërë llogarinë e arkës gjithmonë së paku 15 minuta. Këto bashkë bëjnë 25 minuta në ditë. Mirëpo shefja ime nuk donë të ma paguajë këtë kohë. A duhet të lejojë diç të tillë?

Jo. Si kohë pune vlen tërë koha, në të cilën ju si i punësuar duhet të jeni në dispozicion për punëdhënësin tuaj. Kështu qëndron në nenin 13 të rregullores 1 të ligjit të punës. Në rastin tuaj nuk ka asnjë dyshim, se ju faktikisht duhet që të bëni punën parapërgatitore si dhe atë përmbyllëse, për të qenë e mundur kryerja e punët me arkën. Nuk do të ishte në leverdinë e shefes suaj, sikur ju të fillonit me përgatitjen e arkës tek në ora 8. Me këtë vetëm se do t'irritoheshin myshterintë. Andaj unë ju sugjeroj të kërkoni një bisedë e shefen tuaj dhe t'ia bëni të qartë asaj, se ajo duhet t'ua paguaj juve tërë kohën e punës.

Myriam Muff, work, 20.11.2015

Ekipi redaktues i shtojcës sindikaliste Horizonte ju uron një vit të ri të mbarë, shëndet dhe të gjitha të mirat në jetën familjare, profesionale dhe personale!

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber work, Gewerkschaft Unia, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. García, A. Rogalewski, D. Filipovic, E. Sariasslan, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck NZZ Print, Zürcherstrasse 39, 8952 Schlieren | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft.
Le Syndicat.
Il Sindacato.